



Nr. Prot.

Tiranë, më 7/7/2025

214

**Kriteret dhe Proçedurat e Pranimit për Shtetas Shqiptarë  
në Programin e Studimit "Bachelor" në Ekonomi Ndërmarrjeje  
Raundi i parë, viti akademik 2025- 2026**

Programi e studimit "Bachelor" në *Ekonomi Ndërmarrjeje* ka një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike dhe zhvillohet në gjuhën italiane.

**I. Kuotat dhe kriteret e pranimit**

Për vitin akademik 2025 -2026, në raundin e parë, në dispozicion të kandidatëve shtetas shqiptarë janë **60 kuota** për programin e studimit "Bachelor" në *Ekonomi Ndërmarrjeje*.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- të kenë Diplomë të Shkollës së Mesme;
- plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave VKM nr. 436, dt. 03.06.2020 i ndryshuar me VKM nr. 46 dt. 27.01.2021 sipas së cilit nota mesatare për t'u pranuar në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në vitin akademik 2025- 2026, **duhet të jetë e barabartë ose më e madhe se 6.5;**
- nuk duhet të jenë të regjistruar në programe të tjera studimi.

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nëpërmjet llogaritjes së mesatares së përgjithshme të shkollës së mesme.

**II. Aplikimi**

Për të aplikuar në raundin e parë, kandidatët duhet të përzgjedhin në portalin online U-Albania: <https://ualbania.arsimi.gov.al/> programin e studimit "Bachelor" në *Ekonomi Ndërmarrjeje* të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", **në datat 29 korrik deri në 03 gusht 2025.**

Kandidatët do të renditen sipas mesatares së përgjithshme të shkollës së mesme duke ndjekur rendin zbritës. Lista e renditjes së kandidatëve do të afishohet në ambientet e Universitetit dhe do të publikohet në faqen zyrtare: [www.unizkm.al](http://www.unizkm.al) brenda **datës 25 gusht 2025.** Lista e renditjes sipas kriterit të notës mesatare të raundit të parë do të publikohet edhe në portalin U-Albania.

**III. Regjistrimi/matrikullimi**

Kandidatët që janë shpallur fitues të raundit të parë duhet të regjistrohen pranë Sekretarisë Mësimore **në datat 29 gusht- 11 shtator 2025.** Sipas Udhëzimit nr. 12 dt. 30.06.2023 dhe Urdhrit të përbashkët QSHA-RASH nr. 157, dt. 03. 06. 2025 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) kjo periudhë është e ndarë në 7 faza 48-orëshe (29-30; 31- 01; 02-03; 04-05; 06-07; 08-09; 10-11).



Çdo fazë zgjat 48-orë. Kandidatit të shpallur fitues, i dërgohet një e-mail nga Sekretaria Mësimore ku i komunikohen dokumentet e nevojshme për regjistrim dhe afati 48 orësh për të kryer regjistrimin. Nëse ndonjë prej atyre që pranohen në listën e renditjes nuk regjistrohet në kohë, ai humbet të drejtën e regjistrimit dhe Sekretaria Mësimore thërret automatikisht kandidatin e parë të listës nga jofituesit, i cili është gjithësesi i përshtatshëm (d.m.th. në posedimin e kushteve të përmendura në pikën I më lart). Në rast të mos regjistrimit të mëtejshëm, procedura e lëvizjes së listës së renditjes do të vijojë deri në përfundimin e vendeve në dispozicion, duke përfunduar në datën **11 shtator 2025**. Nëse pas përfundimit të listës së renditjes, do të mbeten ende kuota të paplotësuara dhe nuk do të ketë kandidatë në pritje, do të rikthehen në garë kandidatet e shpallur fitues të cilët nuk janë paraqitur për regjistrim (që nuk rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi). Kandidatët fitues në një program studimi, të cilët nuk janë regjistruar sipas afateve të raundit të parë, humbasin të drejtën për t' u regjistruar në këtë raund, por kanë të drejtën që të plotësojnë formularin e aplikimit të raundit të dytë.

**Për t'u regjistruar, kandidatët e shpallur fitues sipas renditjes së notës mesatare (ku do të përfshihen edhe kandidatët që konsiderohen të përshtatshëm për t'u pranuar në rast të mosregjistrimit të fituesve), duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë Mësimore personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:**

- Mandatpagesë nga Banka për shlyerjen e kështit të parë ose të kështit të plotë<sup>1</sup> të tarifës vjetore të studimit (Urdhërpagesa për t'u paraqitur në bankë shkarkohet nga portali studentit: [portal.unizkm.al](http://portal.unizkm.al), zëri "Tariffe");
- Kopje të njehësuar me origjinalin të Diplomë së Maturës Shtetërore/ Dëftesës së pjekurisë ose të një diplome studimi të fituar jashtë vendit dhe të njehësuar nga QSHA- ja, së bashku me çertifikatën përkatëse të notave.
- Raport mjeko-ligjor që vërteton aftësinë për të ndjekur studimet;
- Vërtetim banimi;
- Certifikatë familjare;
- Fotokopje e një dokumenti identifikimi të vlefshëm (kartë identiteti ose pasaportë);
- Dy fotografi, format dokumenti.

Gjithashtu pranë Sekretarisë Mësimore do të plotësohen:

- Kërkesa e regjistrimit (kërkesa mund të shkarkohet edhe nga portali studentit: [portal.unizkm.al](http://portal.unizkm.al));
- Deklarata e paraqitur në Shtojcat nr. 1 dhe nr. 2 e Udhëzimit nr. 12 dt. 30. 06. 2023 përkatëse;
- Kontrata e regjistrimit;

Në momentin e regjistrimit kandidati duhet të ketë njohuri të mjaftueshme të gjuhës italiane, pasi pranë Universitetit do të kryejë një testim mbi njohjen e gjuhës italiane.

<sup>1</sup> Në rastet kur kandidati plotëson kushtet e parashikuara në Rregulloren e Tarifave për përfitim të bursës vjetore, detyrimi i tij do të jetë në përputhje me tarifën e mbetur





## UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

---

### IV. Procesi i çregjistrimit

Kandidati ka të drejtë të çregjistrohet vetëm **në datat 12- 13 shtator 2025**. Ai paraqet një kërkesë për çregjistrim pranë Sekretarisë Mësimore duke tërhequr dokumentet e dorëzuara. Nëse ky veprim nuk kryhet në këto data, ai nuk ka të drejtë ta ndryshojë programin e studimit për këtë vit akademik. Çregjistrimi kryhet në portalin U-Albania dhe pranë Sekretarisë Mësimore.

Rektori

Prof. Leonardo Palombi

